REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 287/20
Datë/Datum. 28.05.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Visar Basha	18.05.2020	28.05.2020

1.BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 08.05.2020, OE "ND" - Prishtine, ka parashtruar ankesë me nr: 287/19, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "Start - GE", lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me filtera per seperator te vajit te turbines B1&B2" me nr. të prokurimit: 20-441-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Korporata Energjetike e Kosoves.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 32,000.00€.
Datat për fazat e ndryshme të procedurës së tenderit deri në ankesë janë si në vijim: Data e njoftimit për kontratë: 20.02.2020, data e hapjes së ofertës: 23.03.2020, data e vendimit për dhënien e kontratës: 21.04.2020, data e njoftimit të ofertuesve: 21.04.2020.
Ankesa nuk është e përsëritur.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

2.PRETENDIMET ANKIMORE

OE ankues, ne ankesen e tij pretendon se AK-ja nuk i ka respektuar dispozitat e LPP-se, konkretishte nenet: 1, 7, 28, 59, 60 dhe 69 te LPP-se. Pretendimi kryesore i OE ankues eshte se, i rekomanduari per kontrate nuk ka ofruar deshmin/deklaraten e konformitetit nga prodhuesi, kerkese kjo e kerkuar nga AK-ja tek aneksi I - specifikimet teknike te detyrueshme.

3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET

Aneksi 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

Deklarata e prodhuesit se mallrat do të prodhohen sipas certifikatës së konfirmitetit (Certifikata CE).

Gjate fazes se kritereve ka pasur nje pyetje lidhur me kerkesen e lartshenuar.

Pyetja e Operatorit ekonomik.

Aneksi 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

Deklarata e prodhuesit se mallrat do të prodhohen sipas certifikatës së konfirmitetit (Certifikata CE).

Pyetje:

A pranohen produktet pa Certifikaten e Konformitetit CE, te prodhuesit?

Te bashkangjitur shihni deshmin e prodhuesit se produkti prodhohet vetem sipas Deklarates se Konformitetit.

Pra, a duhet te vendoset ne oferte Deklarata e Konformitetit te prodhuesit e produktit te ofertuar?

Pergjigja e AK-se:
Nga dosja e tenderit largohet kerkesa per ofrimin e certifikaten CE te prodhuesit, por duhet te ofrohet nje deklarat e konformitetit nga prodhuesi e cila eshte interne nga vete prodhuesi, pra jo certifikate por deklarate me shkrim.

4. RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:
Sipas raportit te vleresimit te dy OE-te jane te pergjegjshem.

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS

Pretendimi nr.1
Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues ne ankesen e tij ka nje pretendim lidhur me oferten e te rekomanduarit per kontrate, per te cilin pretendon se i njejti nuk ka ofruar deklaraten e konformitetit nga prodhuesi konform sqarimeve te dhena gjate fazes se kritereve, te cilen AK-ja e ka ndryshuar pas pyetjes se nje operatori ekonomik (shih piken 3 te raportit te ekspertizes).

Eksperti shqyrtues, duke u bazuar ne pergjigjen e dhene nga AK-ja, per kerkese ne larteshenuar, sqaron se OE i rekomanduar per kontrate nuk e ka ofruar deshmi sipas kerkeses se AK-se, prandaj eksperti shqyrtues, vlereson se pretendimi i OE ankues qendron per faktin se sqarimet e dhena nga AK-ja gjate fazes se kritereve

sipas dispozitave te LPP-se konsiderohet pjese e dosjes se tenderit dhe njeherit sqaroj se lidhur me kerkesen e AK-se i rekomanduari per kontrate ka ofruar nje certifikate te konformitetit te cilen AK-ja nuk e ka kerkuar.

8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues te aprovohet si e bazuar, ndersa vendimi i AK-se per dhenie te kontrates te anulohet dhe lenda te kthehet ne rivleresim.

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES.
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues - ND.